

Banka e Shqipërisë
Departamenti i Politikës Monetare




Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit

Tremujori i tretë 2014

Treguesi i Ndjesisë Ekonomike

Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) u rrit me 3.7 pikë në tremujorin e tretë të vitit 2014. Aktualisht, niveli i TNE është sa mesatarja e tij afatgjatë, përkatësisht në nivelin 100. Zhvillimet pozitive të këtij treguesi u përcaktuan nga rritja e besimit në sektorët e *industrisë*, të *ndërtimit* dhe të *shërbimeve*, si dhe nga rritja e besimit të *konsumatorëve* gjatë tremujorit të tretë. Nga ana tjetër, rënia e besimit në sektorin e *tregtisë* dha një kontribut negativ në rritjen e TNE-së.

Grafik 1. Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE)




Burimi: Vrojtimi i besimit të biznesit dhe vrojtimi i besimit të konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Sektori i industrisë

Treguesi i besimit në sektorin e industrisë (TBI) u përmirësua me 0.9 pikë përqindje në tremujorin e tretë të vitit. Në këtë tremujor, TBI ka vazhduar të qëndrojë mbi mesataren e tij afatgjatë (me 6.5 pikë përqindjeje) dhe rreth 9.4 pikë përqindjeje mbi mesataren e 5 viteve të fundit. Në rritjen e TBI-së ndikuan pozitivisht rritja e balancës së *gjendjes financiare*, si dhe pakësimi i gjendjes së *inventarëve*. Nga ana tjetër, balanca e *prodhimit*, e cila ka qenë me prirje rritëse duke filluar nga tremujori i dytë i vitit 2013, dha një kontribut negativ në rritjen e TBI-së në këtë tremujor.

Grafik 2. Treguesi i besimit në industri (në pikë përqindje)



Burimi: Vrojtimi i besimit të biznesit, Banka e Shqipërisë.

Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBI-së:

Gjendja e përgjithshme ekonomike është vlerësuar e përmirësuar gjatë tremujorit të tretë të vitit; balanca përkatëse shënoi rritje me rreth 8.2 pikë përqindjeje. Gjithashtu, bizneset që operojnë në sektorin e industrisë kanë vlerësuar në përmirësim *aktivitetin ekonomik të firmës së tyre*, gjatë periudhës në analizë.


Kërkesa e brendshme u vlerësua lehtësisht në rritje gjatë tremujorit aktual (+0.6 p.p.). Nga ana tjetër, kërkesa e huaj, ndonëse balanca e saj mbetet me shenjë pozitive, është vlerësuar në ngadalësim në krahasim me tremujorin e kaluar (-3.6 p.p.). Bizneset në sektorin e industrisë vlerësojnë në rritje çmimet e prodhimit për tremujorin e tretë të vitit.

Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në industri shënoi nivelin 74.32%, në përmirësim me rreth 2.7 pikë përqindje në krahasim me tremujorin e kaluar. Shfrytëzimi i kapaciteteve në këtë sektor qëndron mbi mesataren e tij afatgjatë. Niveli i *investimeve* në industri është vlerësuar në rënie krahasuar me fillimin e vitit.

Sektori i ndërtimit

Treguesi i besimit në sektorin e ndërtimit (TBN) shënoi një përmirësim të lehtë me rreth 2.8 pikë përqindjeje, në tremujorin e tretë. Ky tregues ka ardhur në përmirësim që prej tremujorit të parë të vitit 2014. Niveli aktual i TBN-së qëndron rreth 4.5 pikë përqindjeje nën mesataren e tij afatgjatë, por 7.6 pikë përqindjeje mbi mesataren e pesë viteve të fundit. Rritja e TBN-së erdhi si pasojë e përmirësimit të të tre balancave përbërëse të tij. Kështu, vlerësimi i bizneseve mbi situatën aktuale të *kërkesës*, të *prodhimit* dhe të *punësimit*, u përmirësua respektivisht me 3.6, 2.8 dhe 2.1 pikë përqindjeje, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit.

Grafik 3. Treguesi i besimit në ndërtim (në pikë përqindje)



Burimi: Vrojtimi i besimit të biznesit, Banka e Shqipërisë.

Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBN-së:


Situata e përgjithshme ekonomike në vend dhe gjendja e përgjithshme e biznesit u vlerësuan në përmirësim gjatë tremujorit të tretë të vitit. Stoku i banesave vlerësohet të jetë rritur lehtësisht gjatë kësaj periudhe, ndërkohë që gjendja financiare e bizneseve është vlerësuar në rënie. Çmimet e prodhimit në ndërtim janë vlerësuar në rritje në tremujorin e tretë të vitit.

Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese në sektorin e ndërtimit rezultoi rreth 57.9%. Kjo normë rezulton në rritje me rreth 1.3 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e mëparshëm, por rreth 7.4 pikë përqindje nën mesataren historike. Bizneset në sektorin e ndërtimit vlerësojnë në rënie nivelin e investimeve, krahasuar me tremujorin e parë të vitit.

Sektori i shërbimeve

Treguesi i besimit në sektorin e shërbimeve (TBSH) u rrit me 0.4 pikë përqindje në tremujorin e tretë. Duke nisur nga tremujori i katërt i vitit 2013, TBSH është në prirje rritëse dhe aktualisht qëndron rreth 1 pikë përqindje mbi mesataren historike. Rritja e TBSH-së, në tremujorin e tretë, u përcaktua kryesisht nga rritja e balancës së gjendjes së përgjithshme të biznesit (+1 pikë përqindjeje). Dy komponentët e tjerë përbërës dhanë një kontribut shumë më të vogël, përkatësisht balancat e kërkesës dhe e gjendjes financiare u rritën me 0.1 pikë përqindje.

Grafik 4. Treguesi i besimit në shërbime (TBSH)



Burimi: Vrojtimi i besimit të biznesit, Banka e Shqipërisë.

Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBSH-së:

Ndërmarrjet e sektorit të shërbimeve kanë vlerësuar në përmirësim *situatën e përgjithshme ekonomike* në vend, balanca përkatëse u rrit me 3.1 pikë përqindjeje. Pritjet për këtë situatë, ndonëse në nivel më të lartë se vlerësimi për gjendjen korrente, janë në ulje nga tremujori i dytë. Ndërkohë pritjet e bizneseve janë më optimiste për *gjendjen e biznesit të tyre* në tremujorin e katërt, balanca përkatëse u rrit me 18 pikë përqindje.


Bizneset vlerësojnë me rritje të lehtë *çmimet e shërbimeve* të tyre gjatë tremujorit të tretë. Balancat e çmimeve në shërbime kanë regjistruar prirje rënëse gjatë dy viteve të fundit.

Bizneset kanë shfrytëzuar në masën 76.1% kapacitetet e tyre, përfaqësisht në të njëjtin nivel me mesataren afatgjatë të këtij treguesi. Balanca e investimeve të reja të kryera gjatë gjashtëmujorit të fundit u përmirësua, pas rritjes së theksuar në tremujorin e katërt 2013. Aktualisht vlera e kësaj balance qëndron ndjeshëm mbi mesataren e saj afatgjatë.

Sektori i tregtisë

Treguesi i besimit në tregti (TBT) ra me rreth 5 pikë përqindje në tremujorin e tretë, i ndikuar negativisht nga rënia e balancës së *gjendjes së biznesit* dhe e balancës së *punësimit*. Komponenti i tretë i treguesit, *gjendja financiare*, nuk pësoi ndryshim në krahasim me nivelin e tremujorit të dytë. Niveli i TBT-së, i cili regjistroi rritje tre tremujorët e kaluar, qëndron mbi mesataren e tij afatgjatë me 4.4 pikë përqindje.

Grafik 5. Treguesi i besimit në tregti (TBT)



Burimi: Vrojtimi i besimit të biznesit, Banka e Shqipërisë.

Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBT-së:


Situata e ekonomisë në përgjithësi është vlerësuar e përmirësuar nga bizneset e sektorit të tregtisë. Balanca e saj u rrit me 10.5 pikë përqindje në krahasim me tremujorin e dytë. Njëkohësisht, vlerësimi për *kërkesën* në këtë sektor është rritur- balanca ndryshoi me +6.3 pikë përqindje në tremujorin e tretë në krahasim me të dytin. Balanca e *çmimeve* u vlerësua me rritje nga tremujori i kaluar. Balanca e *investimeve të reja* ka rënë në krahasim me gjashtë muaj më parë.

Norma e *shfrytëzimit të kapaciteteve* në tregti është 79.2%, rreth 1.5 pikë përqindje më e lartë se tremujori i kaluar. Aktualisht, kjo normë qëndron shumë afër nivelit të mesatares afatgjatë.

Besimi i konsumatorëve

Besimi i konsumatorëve, në tremujorin e tretë të vitit 2014, u përmirësua për të dytin tremujor rresht. Treguesi i besimit të konsumatorëve (TBK) u rrit me 5 pikë përqindjeje, pasi kishte shënuar rritje me 2.4 pikë përqindje në tremujorin e dytë të vitit. Niveli i TBK-së aktualisht qëndron 3.5 pikë përqindje mbi mesataren afatgjatë (Grafiku 6). Në rritjen e TBK-së ndikoi kryesisht përmirësimi i balancës së pritjeve për *situatën financiare* të konsumatorëve dhe përmirësimi i balancës së *blerjeve të mëdha*. Balanca e pritjeve për *situatën e ekonomisë në përgjithësi* pothuaj nuk ndryshoi nga tremujori i kaluar, ndërsa balanca e të *ardhurave-shpenzimeve* regjistroi rënie në këtë tremujor.

Grafik 6. Treguesi i besimit të konsumatorëve (TBK)



Burimi: Vrojtimi i besimit të konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBK-së:

Pritjet e konsumatorëve për nivelin e *papunësisë* në gjashtë muajt e ardhshëm janë pothuaj në të njëjtin nivel me tremujorin e kaluar. Në përgjithësi, balanca e papunësisë ka qenë në një trend rënës që nga tremujori i parë i vitit 2013 (ulja e balancës tregon për papunësi të pritur në rënie). Pritjet për inflacionin përsuan rritje të lehtë në tremujorin e tretë, përkatësisht në 1.6% nga 1.3% tremujorin e parë. Në krahasim me mesataren afatgjatë, pritjet për inflacionin janë 0.5 pikë përqindje më të ulëta. Konsumatorët raportojnë përmirësim të situatës së *kursimit* në tremujorin e tretë.

Tabelë 1. Treguesit e besimit sipas sektorëve*

	Vlerat që nga T2-2002			2013		2014			Situata aktuale	
	min.	mes.	max.	T3	T4	T1	T2	T3	Konjunkturale**	Strukturore***
Industri	-18.7	-2.8	9.0	-9.5	-7.6	-2.4	2.7	3.6	↑	+
Ndërtim	-37.8	-10.6	9.3	-33.8	-34.0	-20.1	-17.9	-15.1	↑	-
Shërbime	-22.7	0.8	21.4	-21.4	-13.3	-2.8	1.3	1.7	↑	+
Tregti	-17.3	-2.1	9.7	-17.3	-9.7	2.5	7.2	2.3	↓	+
Konsumator	-20.5	-12.4	-6.4	-11.4	-16.2	-16.4	-14.1	-9.1	↑	++

Burimi: Vrojtimi i besimit të konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

*) Me përjashtim të treguesit të konsumatorit, treguesit janë llogaritur nga balanca të rregulluara për sezonalitet.

**) Situata krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

***) Situata për secilin tregues konsiderohet shumë e kënaqshme (+ +) kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; situata konsiderohet e kënaqshme (+) kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; situata konsiderohet e pakënaqshme (-) kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja; dhe situata konsiderohet shumë e pakënaqshme (-) kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja.


Tabelë 2. Balancat kryesore të sektorëve të ekonomisë (në pikë përqindje)*

	2013			2014		
	T2	T3	T4	T1	T2	T3
Kërkesa						
Total	-22.1	-24.0	-21.8	-10.4	-5.0	-3.6
Industri	-15.3	-11.9	-14.5	-4.08	4.8	5.4
Ndërtim	-35.8	-40.9	-38.2	-25.8	-22.4	-18.8
Shërbime	-18.5	-19.1	-12.8	-1.3	2.6	2.7
Tregti	-18.7	-24.2	-17.3	-2.6	1.5	7.9
Gjendja e përgjithshme e biznesit						
Total	-24.2	-24.8	-20.9	-12.4	-5.8	-1.4
Industri	-19.3	-14.1	-11.8	-9.4	3.1	5.6
Ndërtim	-30.3	-36.9	-36.1	-26.3	-21.5	-11.9
Shërbime	-23.0	-23.3	-14.7	-1.6	1.2	2.2
Tregti	-22.7	-24.7	-20.4	-10.0	-2.5	-1.1
Prodhimi						
Total	-27.7	-22.6	-24.3	-12.6	-3.7	-3.4
Industri	-20.1	-9.3	-8.6	-3.0	10.5	8.3
Ndërtim	-35.3	-35.9	-40.0	-22.1	-18.0	-15.2
Konsumatorët						
Situata financiare	-9.7	-8.9	-16.0	-13.5	7.2	-4.0
Çmimet pas 1 viti, në %	2.0	2.2	2.3	1.5	1.3	1.6
Blerje të mëdha	-46.5	-53.8	-54.7	-59.4	-58.0	-46.7
Situata e kursimit	-53.1	-51.1	-48.3	-39.3	-41.0	-36.7

Burimi: Vrojtimi i besimit të konsumatorit, Banka e Shqipërisë.


*) Me përjashtim të sektorit të konsumatorit, balancat janë të rregulluara për sezonalitet.

Grafik 7. Balancat kryesore të vrojimit të konsumatorit.



Burimi: Vrojtimi i besimit të konsumatorëve, Banka e Shqipërisë.

Grafik 8. Balancat kryesore të vrojtimet të bizneseve, të agreguara në nivel ekonomie



Burimi: Vrojtimi i besimit të biznesit, Banka e Shqipërisë.

Aneks

Shpjegime metodologjike

-**Balanca** është treguesi që përdoret më shpesh për agregimin e të dhënave cilësore nga vërtetimet. Ajo llogaritet si diferencë midis përqindjes së përgjigjeve pozitive dhe përqindjes së përgjigjeve negative. Balanca shprehet në pikë përqindje.

-**Treguesi i Besimit** (TB) ndërtohet për çdo sektor dhe llogaritet si mesatare e thjeshtë e balancave të rregulluara sezonalisht, të treguesve të cilët kanë korrelacionin më të lartë me serinë e referencës (serinë e të dhënave reale të ekonomisë).

-**Treguesi i Ndjesisë Ekonomike** (TNE) përmbledh të gjitha balancat (13) e përdorura për llogaritjen e treguesve të besimit për të katër sektorët, të peshuara sipas aktivitetit ekonomik. Ai shpreh me anë të një treguesi të vetëm, ndjesitë për aktivitetin ekonomik në vend, të dy prej grupeve kryesore ekonomike: biznesit dhe konsumatorëve.